

RINOVIMI I LEJES SË DREJTIMIT

A. Dokumentat për rinovimin e lejes së drejtimit (dëmtim, humbje ose vjedhje)

1. Kërkesë me shkrim, pranë Drejtorisë Rajonale;
2. Dokument identifikimi;
3. Leje e drejtimit ekzistuese origjinale (për rastin e dëmtimit);
4. Certifikatë mjeksore me fotografi, të lëshuar me datë jo më përpara se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
5. Vërtetim banimi të lëshuar nga organet e pushtetit vendor;
6. Deklaratë e marrjes së përgjegjësisë administrative (vetëm për rastet e humbjes ose të vjedhjes);
7. Vërtetimin e denoncimit të lëshuar nga Policia (për rastet e humbjes ose vjedhjes); shërbimi kryhet pas 30(tridhjetë) ditëve nga data e depozitimit të denoncimit);
8. Dokumentin e përcaktimit të grupit të gjakut dhe rehzusin (jo për ata që kanë patur leje drejtimi dixhitale);

Personi pajiset me Lejedrejtimi provizore, afati i së cilës është 30 ditë pas datës së denoncimit.

Pas këtij afati qytetari pajiset me lejedrejtimi.

B. Dokumentat për rinovimin e lejes së drejtimit për ndryshim vendbanimi

1. Kërkesë me shkrim për transferim dosje;
2. Dokument identifikimi të lëshuar nga organi i vendbanimit të ri;
3. Vërtetim i vendbanimit të ri të lëshuar nga organet përkatëse të pushtetit vendor;
4. Lejedrejtimi ekzistuese;
5. Certifikatë mjeksore, të lëshuar me datë jo më shumë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës (vetëm për rastet kur pajiset për herë të parë me lejedrejtimi të ri ose ku i ka kaluar afati i vlefshmërisë së lejes pararendëse);
6. Dokumentin e analizës së Grupit të gjakut dhe Rehzusin, (vetëm kur pajiset për herë të parë me lejedrejtimi dixhitale);
8. Kërkesa e aplikantit së bashku me dokumentacionin për transferim dosje, mund të depozitohet në Drejtorinë Rajonale, të vendbanimit të ri ose në atë të vendbanimit të mëparshëm.

C. Lëshimi i Vërtetimeve mbi bazën e kërkesës së qytetarëve

a. Vërtetim për përdorim brënda vendit

1. Kërkesë me shkrim e bërë pranë Drejtorisë Rajonale;
2. Dokument identiteti (fotokopje);
3. Fotokopje e lejedrejtimit.

b. Vërtetim për përdorim për jashtë vendit

1. Kërkesë me shkrim e bërë pranë Drejtorisë Rajonale;
2. Dokument identiteti (fotokopje);
3. Fotokopje e lejedrejtimit.

Procedura zgjat jo më shumë se 20 minuta.

Autorizimi është i vlefshëm deri në 3 (tre) muaj nga data e lëshimit të tij.

Vërtetimi, në të dy rastet, e ka vlerën e pagesës 200 lekë.

D. Lëshimi i lejeve të drejtimit ndërkombëtare

1. Kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale përkatëse;
2. Lejedrejtimi kombëtare (në origjinal me të drejtë rikthimi);

3. Fotografi me ngjyra(një)copë.

Aplikanti paraqet, në sportelin përkatës të Drejtorisë Rajonale, dokumentet e kërkuara; Lejedrejtimi Ndërkombëtare lëshohet menjëherë.

Afati i vlefshmërisë është 1(nje) vjeçar.

Pagesa për Lejedrejtimi Ndërkombëtarë është 500 lekë.

E.Konvertimi i Lejeve të Drejtimit

Dokumentat për konvertimin e lejeve të lëshuara nga shtetet e huaja, në leje drejtimi shqiptare

a-Për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, rezidentë në Shqipëri

1. Kërkesë e aplikantit pranë Drejtorisë Rajonale përkatëse;
2. Leja e drejtimit origjinale e lëshuar nga shteti përkatës (pa skaduar afati i vlefshmërisë) dhe fotokopje e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e legalizuar nga noteri (origjinali i rikthehet deri në momentin e njehsimit);
3. Dokument identifikimi, ndërsa për shtetasit e huaj fotokopje të pasaportës, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuar nga noteri;
4. Vërtetim banimi të lëshuar nga organet e pushtetit vendor, ndërsa për shtetasit e huaj, fotokopje të lejes së qëndrimit të lëshuar nga organet e policisë së shtetit, të legalizuar nga noteri;
5. Certifikatë mjekësore me fotografi, të lëshuar me datë jo më parë se 3 (tre)muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
6. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin.

b-Për personelin e huaj të Ambasadave ose të organizatave Ndërkombëtare që gëzojnë statusin diplomatik, të instaluar në Shqipëri

1. Nota verbale e lëshuar nga Ambasada ose Organizata Ndërkombëtare;
2. Fotokopje e kartës së legjitimitetit të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme;
3. Fotokopje e pasaportës së legalizuar nga Ambasada ose Organizata Ndërkombëtare;
4. Fotokopje e lejes përkatëse të drejtimit (kombëtare) të përkthyer dhe të legalizuar nga Ambasada ose nga Organizata Ndërkombëtare;
6. Certifikatë mjekësore me fotografi lëshuar me datë jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës;
7. Dokumentin e përcaktimit të Grupit të Gjakut dhe Rehzusin.

Procedura zgjat në varësi të kohës së kthimit të përgjigjes nga ana e autoriteteve lëshuese të lejes së drejtimit të huaj.

Vlefshmëria është në varësi të kategorisë, moshës dhe afatit të qëndrimit në Shqipëri.

Pagesa për paisjen me leje drejtimi është 3500 lekë.